

EDMOND MALAJ

DRISHTI NË MESJETË

Dikur, Drishti një qytet i lulëzuar, një ipeshkvi që njihej që në shek.IX, me katedrale, shkolla dhe me një jetë dhe kulturë urbane mjaft të zhvilluar për kohën, është sot vetëm një grup shtëpish gjysmë të braktisura (bëhet fjalë këtu për Drishtin e Vjetër). Pushtimi osman, si shumë qyteteve të tjera mesjetare shqiptare i dha edhe Drishtit “goditjen për vdekje”, duke bërë kështu, që ai të shuhej dhe të kthehej në një gërmadhë të zezë, të cilën sot kur e sheh të zë trishtimi. Qëllimi i këtij artikulli është përpjekja për të dhënë në mënyrë modeste disa informacione nga identiteti që pati Drishti gjatë Mesjetës, duke u mbështetur në disa burime shkencore dhe arkivale, që munda t’i gjej gjatë kërkimeve që bëra në lidhje me historinë e këtij qyteti. Duhet të shtoj këtu që informacionet që ofrojnë enciklopeditë dhe studimet historike rreth kësaj qendre janë shumë të pakta (për mos të thënë të mjerueshme) dhe duket sikur shteti shqiptar qoftë gjatë kohës së diktaturës komuniste, qoftë gjatë kohës së sotme nuk ka bërë asnjë gërmim arkeologjik për të nxjerrë sadopak në pah aspekte nga ekzistenca mesjetare e kësaj qendre.

Pozicioni gjeografik

Po të udhëtosh nga Shkodra në drejtim të verilindjes arrin pas 12-13 km në fshatin e sotëm Drisht që ndodhet në luginën e lumit Kiri, në krahinën e Postribës.¹ Ky fshat i ri është i formuar kryesisht në dhjetëvjeçarët e fundit nga popullsi të zonave përreth dhe nuk



Fig. 1. Vështrim mbi fshatin e ri të Drishtit nga porta jugore e qytetit të vjetër të Drishtit. Foto: E. Malaj

¹ *Krh. Ermano Armao, Vende, kisha lumenj, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore*, Tiranë: “Korbi”, 2006, f. 73. (Cituar në vazhdim si: Armao, *Vende, kisha lumenj ...*, f.).

është fshati i vjetër i Drishtit që ndodhej deri vonë, para se të braktisej, jashtë mureve të kështjellës së vjetër. Sot aty ndodhen vetëm disa shtëpi të banuara dhe disa të tjera që janë të braktisura sidomos vitet e fundit. Fshati dikur ishte më i madh dhe në fillim të shekullit të njëzetë ka pasur 80 shtëpi². Në Mesjetë ky lokalitet quhej *Drivasto*.³

Kështjella e këtij qyteti, sipas Jirečekut, e ka origjinën ndoshta nga



Fig. 2. Cisterna e ujit. Foto: E. Malaj

koha romake ose koha ilire.⁴

Ky lokalitet gjendet mbi një kodër afërsisht 150 m të lartë, e cila nga Veriu dhe Perëndimi kufizohet prej luginës së thellë të Kirit dhe nga Jugu prej honit të *Prronit* të Drishtit. Kështu kjo kështjellë mund të arrihej vetëm nga ana lindore, anë në të cilën ndodhej e ashtuquajtura 'Porta e Shalës', kurse porta kryesore e qytetit ishte nga ana e Jugperëndimit.

Tek njëra nga këto porta, si pjesë e saj, gjendej një gurë me emblemë në formë të çregullt, brenda së cilës ishin skalitur tre yje.⁵ Emblema ishte e skalitur në një bllok të bardhë guri, në formë katrore dhe kishte afërsisht

² *Krh.* Spiridon Gopčević, *Das Fürstentum Albanien, seine Vergangenheit, ethnografischen Verhältnisse, politische Lage und Aussichten für die Zukunft*, Mit 16 Tafeln (25 Abbildungen) und 1 Karte. 2. Auflage. Berlin: "Paetel" 1914, f. 307. (Cituar si në vazhdim si Gopčević, *Das Fürstentum Albanien ...*, f.).

³ *Krh.* Konstantin Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 111. (Cituar si: Jireček, "Skutari", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f.).

⁴ *Krh.* Po aty, f. 111.

⁵ *Krh.* Theodor Ippen, "Monumente të periudhave të ndryshme në Shqipëri", në *Shqipëria e Vjetër. Studime gjeografike, etnografike, historike nga ish-konsulli i përgjithshëm i monarkisë austro-hungareze në Shkodër*. Përkthyer nga origjinali: Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi. Me riprodhimin e fotografimeve dhe skicave origjinale të Ippenit. Tiranë: K&B 2002, f. 186. (Cituar si: Ippen, "Monumente ...", në: *Shqipëria e Vjetër ...*, f.) *Krh. dhe* Jireček, "Skutari", në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 111. (Sot nuk gjendet më as ky objekt – E.M.).

përmasat 49 x 47 cm dhe nuk dihet, se çfarë kuptimi kishte dhe çfarë simbolizonte.⁶ Duhet të kihet **parasysh që qyteti duhet të shikohet veças nga kështjella** (*Castrum et civitas* = kështjella dhe qyteti – E. M.), sepse kështjella e ashtuquajtur *Kalaja e Drishtit* gjendet 60-80 metër më lart, në majë të kodrës dhe kishte formë poligonale (me shumë kënde) të parregullt, ku vihen re edhe mbeturina kullash.⁷ Në brendësi të saj nuk kishte burime dhe në kohën veneciane (1397-1404) bëhej fjalë edhe për nevojën e ndërtimit të një cisterne, duke i marrë paratë që nevojiten për ndërtimin e saj, nga hyrjet në të holla, që grumbullonte qyteti,⁸ dhe nëse ato të hodha nuk do të mjaftonin, mendonin t’i shkruanin kapitenit të Shkodrës që të kontribuonte me ndonjë shumë nga paratë e atij qyteti.⁹ Porse në rrënojat e kësaj kështjelle sot nuk konstatohet asnjë mbetje nga ndonjë cisternë e dikurshme.* E vetmja cisternë (saranxhë) që gjendet atje, ndodhet poshtë kalasë, në fshatin e vjetër të Drishtit, ku ka qenë dikur qyteti. Cisterna është akoma edhe sot në gjendje të mirë, është brenda e ndërtuar me mure dhe plot me ujë dhe sipas fjalëve të një fshatari të atyshëm, ajo përdoret edhe sot për të nxjerrë ujë për përdorime të ndryshme. Duhet të përmendet këtu fakti që qytetit dhe kalasë së dikurshme edhe pse nuk kanë burime atje sipër, nuk duhet t’u ketë munguar uji, pasi poshtë kodrës rrjedhin lumi Kiri dhe ‘*Përroi i Drishtit*’, siç u tha edhe më sipër.

Malet që ngrihen pas Drishtit në veri të Drinit, venecianët i quanin në shek.XVI ‘*Malet e Shpanëve*’ (*monti delli Spani*), kurse malet në jug të Drinit i quanin ‘*Malet e Dukagjinëve*’ (*monti delli Ducagini*) dhe emrat e luginave përreth kishin pjesërisht emërtime romane, p. sh.: Fundina (Fontana), Kruçë (Cruce = Crux) 1402.¹⁰

⁶ *Krh.* Ippen, “Monumente ...”, në: *Shqipëria e Vjetër ...*, f. 186.

⁷ *Krh.* Sufflay, *Städt und Burgen Albaniens*, f. 26.

⁸ “*Sed quia similiter est necesse, quod aptetur cisterna castris nostri Drivasti, ordineretur, quod, quod potestas noster Drivasti aptari fecere debeat cisternam dicti castris faciendo illam expensam, quo erit necesaia, de introitibus nostris Drivasti [...].*” *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens) (Nr. 555 et passim) Vindobonae MCMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 595, f. 167. (Cituar si: *AAlb. II*, nr. i dokumentit, f.).

⁹ *Krh.* *AAlb. II*, nr. 595, f. 167.

* Kështjellën e kam vizituar personalisht dhe nuk kam vënë re asnjë gjurmë të ndonjë cisterne brenda saj – E.M.

¹⁰ *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 114.

Të dhëna historike

Akoma deri më sot nuk e dimë, se kur është themeluar ky qytet. Sipas Ippenit aty gjendej një gurë varri nga koha e Perandorisë Romake dhe vetëm ky objekt, na çon në hipotezën që qyteti mund të ketë qenë i banuar që në atë kohë.¹¹ Përshkrimin e këtij guri së bashku me mbishkrimin në latinisht, Ippeni e jep si më poshtë:



Fig. 3. Mbetje nga qyteti i vjetër i Drishtit. Foto: E. Malaj

“Guri është i thyer në pjesën e sipërme nga ana e djathtë, por nga mbishkrimi nuk ka humbur asgjë. Ky i fundit rrethohet nga një kornizë me profil; poshtë saj një fushë e përzgjatur zbukurohet nga një vazo dyvegjake me bark të fryrë dhe nga dy vila të mëdha rrushi. D. M. është vendosur mbi kornizë me siguri për mungesë vendi. Midis shkronjave dallohet një O, por kjo duhet të jetë një shenjë e madhe pikësimi. Në radhët 4, 6 dhe 8 germat e fundit O, përkatësisht C dhe T ndodhen

në brezin anësor. *D(is) M(anibus) infelicissimo Aurelio aequiti Romano, q(qui) vix(it) an(nos) XXXVIII ... marito p[ie]ntissimo po[su]it.*”¹²

Qyteti ka qenë gjatë Mesjetës së hershme pjesë e Perandorisë Bizantine. Bizantinët donin që t’i jepnin këtij qyteti një origjinë bizantine, sepse sipas Ippenit, “një dokument i gjetur në arkivin e Vatikanit, sipas gjasave apokrif, bëhet shkas për të hedhur një hipotezë të paqëndrueshme, se Drivastum është themeluar nga familja bizantine Angelos, nga e cila vijnë perandorët e viteve 1185-1204 dhe se kjo familje, si e përzunë latinët, qe tërhequr në Drivastum dhe kishte sunduar atje”¹³. Ky dokument pretendohet se ishte një “diplomë emërimi e lëshuar nga perandori Mihali VIII Paleologu (1261-1282) për dukët e Drivastos Mihal Angelos dhe të birin e tij Andrea Angelos, por sipas të gjitha gjasave duket se këto marrëdhënie të familjes Angelos me Drivastum nuk

¹¹ Gurin e varrit romak, që përmend Ippeni, nuk munda ta gjej në vizitën që bëra atje. (E. M.) Ippeni thotë që guri, “i cili u gjet i murosur gjatë shkatërrimit të një ndërtimi të vjetër edhe sot (vitet 1900-1907 - E. M) ndodhet në shtëpinë e bajraktarit të Drishtit.” Ippen: “Monumente ...”, në: *Shqipëria e Vjetër ...*, f. 187.

¹² Po aty.

¹³ Po aty, f. 184.

kanë ekzistuar kurrë.”¹⁴ Gjatë gjysmës së dytë të shek. XI qyteti ra nën pushtetin e Bodinit të Dioklesë,¹⁵ dhe që nga viti 1185 në duar të serbëve, sepse Nemanja e pushtoi atë njëkohësisht me Shkodrën.¹⁶ Nën sundimin serb, sipas Jirečekut, qyteti mbeti si një bashkësi e privilegjuar me nëpunës të zgjedhur dhe ligje lokale, dhe mbretin aty e përfaqësonte një kapiten (*comes*) (1251).¹⁷ Drishti (por edhe Shasi) - siç na tregon arkidiakoni Tomas i Spolatos († 1266) - u plaçkit njëherë nga tatarët (sipas Shufflait, nga mongolët) në vitin 1242 dhe banorët e këtyre qyteteve u dhunuan prej tyre, kur ata duke u nisur nga Hungaria kaluan nëpër Dalmaci dhe donin të ktheheshin përsëri në Rusi, duke kaluar nëpër Serbi dhe Bullgari.¹⁸ Muret e këtij qyteti në atë kohë, nëse i referohemi arkidiakonit Tomas të Spolatos, ishin të dobëta, pra qyteti nuk ishte shumë i fortifikuar,¹⁹ gjë që çoi në plaçkitje të lehtë të tij nga një armik që kishte ardhur nga larg dhe ishte kalimtar.

Por Drishti pas kësaj plaçkitjeje u ringjall sërish plotësisht, dhe sipas Shufflait, duke iu referuar traditës së shek.XV, kjo ringjallje e qytetit (1282-1324) qe meritë e mbretëreshës serbe Helena, e cila ishte me origjinë franceze.²⁰

Prej vitit 1393-1395 Drishti së bashku me Shkodrën ishin nën sundimin e osmanëve, por Drishti ra në vitin 1396 nën sundimin e venedikasve dhe Republika e Venedikut u njohu drishtjanëve “Statutet e vjetra” (*antiqua Statua*), rregulloi kufijtë midis këtij qyteti dhe Shkodrës dhe siguroi shitjen e verës që prodhohej në vend duke ndaluar shitjen e verës së huaj.²¹ Gjatë kohës që osmanët kërcënonin Drishtin ikën prej aty, me sa duket, shumë banorë dhe klerikë, sepse në vitin 1399 në Raguzë ndeshim një koloni të madhe priftërinjsh drishtjanë, të cilët ishin larguar për shkak të rrezikut turk.²² Urdhëruesi në këshillin e Drishtit (*comitatus*

¹⁴ Po aty.

¹⁵ *Krh. Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit.* (Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis). Dr. Musa Ahmeti dhe Dr. Etleva Lala. Tiranë: OMBRA GVG 2009, f. 43. (Cituuar si: *Statutet dhe urdhëresat*, f.).

¹⁶ *Krh. Šufflay: Städt und Burgen Albaniens*, f. 27.

¹⁷ *Krh. Jireček, “Skutari”, në: Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 111-112.

¹⁸ *Krh. Po aty*, f. 112. *Krh. edhe Šufflay: Städt und Burgen Albaniens*, f. 27.

¹⁹ *Statutet dhe urdhëresat*, f. 43.

²⁰ *Krh. Šufflay: Städt und Burgen Albaniens*, f. 27.

²¹ *Krh. Jireček, “Skutari”, në: Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 112.

²² *Krh. Statutet dhe urdhëresat*, f. 48.

Drivasti) ishte një pushtetar venedikas (potestas). Balsha III u mundua ta pushtonte qytetin përsëri.²³ Gjatë një rrethimi të gjatë në vitin 1418 nga ai (Balsha III) trupat që ndodheshin brenda të rrethuara në kështjellë, u pakësuan aq shumë nga uria dhe nga etja, sa komandantit Korrer (*Correr*) i mbetën vetëm 40 ushtarë.²⁴ Kështu Balsha në një ditë me shi të shtatorit të këtij viti e sulmoi kështjellën, duke iu shkaktuar dëme drishtianëve, dhe arriti të zinte rob pushtetarin së bashku me gruan e tij.²⁵ Diku para muajit qershor të vitit 1416 u futën në Drisht sasi parash që do të shërbenin për të blerë tek osmanët lirinë në rastin se do t'u kërcënohej pushtimi nga ata.²⁶ Në verën e vitit 1419 pati një mot të nxehtë dhe një shtator shumë të thatë ku u shteruan të gjitha rezervat e ujit në qytet dhe kështu trupat veneciane që ishin brenda në kështjellë filluan të kishin shumë probleme; por moti në Drisht, ndodhte të ishte i vështirë edhe në dimër, për shembull në vitin 1421 pati një dimër me temperatura shumë



Fig. 4. Portë në veriperëndim të Drishtit.
Foto: E. Malaj

të ulëta, sa që ata (venedikasit) nga të ftohtët qenë të detyruar të ndërprinin lëvizjet e trupave.²⁷

Në vitin 1421 trupat e despotit e pushtuan Drishtin, kjo që ndodhi, venecianëve iu duk mjaft e rëndë, “*sepse pa Drishtin qyteti i Shkodrës vliente pak (qua sine Divasto civitas Scutari parum valet)*”.²⁸

Despotët serbë e patën Drishtin nën sundimin e tyre deri në vitin 1442, porse në aktet serbe Drishti përmendet deri në vitin 1442 si pjesë e “Zetës së

²³ *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 112.

²⁴ *Krh.* Po aty.

²⁵ *Krh.* Po aty.

²⁶ *Krh.* Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenburg 2001. (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.), f. 51. (Cituar si: Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f.)

²⁷ *Krh.* Po aty, f. 70.

²⁸ *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 112.

Poshtme”²⁹. Më vonë Drishtin e morën vene-cianët, sepse në vitin 1426 në Drisht qe nënshkruar midis Venedikut dhe Serbisë një marrëveshje kufiri, ku vendosej që pas vitit 1442, Drishti u kalonte venecianëve, të cilët e patën këtë qytet nën juridiksionin e tyre për pothuaj 35 vjet, pra nga viti 1442 deri në vitin 1478, pasi ata i kishin rinjohur privilegjet që ky qytet kishte pasur.³⁰

Kur qytetin e morën venecianët i gjetën muret në një gjendje të keqe, të cilat kishin nevojë për një rinovim të madh dhe të menjëhershëm,³¹ por që pas vitit 1467 u bë shumë pak për rindërtimin dhe fortifikimin e qytetit.³²

Midis të tjerëve që kanë sulmuar Drishtin është edhe Skënderbeu. Ai e sulmoi Drishtin nga Baleci (Balezo) mesa duket disa herë.³³ Biemmi dhe Gopçeviqi na informojnë mbi një sulm që i bën Hamza Kastrioti qytetit të Drishtit në vitin 1448 (sipas Gopçeviqit 1446), megjithëse ai kishte marrë urdhrin nga Skënderbeu që të sulmonte qytetin e Balcit e jo Drishtin.³⁴ Qytetin e mbron me sukses Andrea Engjëlli, duke dalë papritur jashtë portave, veprim ky që çoi në hutimin dhe shpërndarjen e ushtrisë së Hamzait, i cili u hakmor për këtë humbje duke djegur dhe shkretuar zonën përreth.³⁵ Një përshkrim të këtij sulmi e gjejmë tek vepra e Giammaria Biemmit, si më poshtë:

“Me kaq pak forca ushtarake, porse me besim në vetvete u nis me ushtrinë e vogël në drejtim të Drishtit. Drishtjanët, të lajmëruar nga rojet që rrinin jashtë mureve në drejtim të Balcit, shkuan të merrnin armët dhe vrapuan të zinin muret dhe portat, dhe si zakonisht çuan aty gurëdhëse dhe makina të tjera që përdorëshin në atë kohë për mbrojtjen e shesheve, porse, kur vunë re nga afër numrin e vogël të armiqve dhe kur njohën atë që po u printe atyre, frika që kishin në fillim u shndërrua menjëherë në përbuzje dhe sharje. Hamzai pa që muret ishin të mbushura plot me armë dhe njerëz të armatosur, dhe që garnizoni në pjacën e qytetit ishte me i madh në numër se ushtria e tij me të cilën donte të bënte rrethimin, dhe kështu, pa e zvogëluar “trimërinë” e tij të mëparshme dërgoi një herold që t’u kërkonte atyre të pjacës së qytetit, që t’i hapnin portat në emër të

²⁹ *Krh* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 51. Referencë 19.

³⁰ *Krh*. Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 112.

³¹ *Krh*. Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 99.

³² *Krh*. *Statutet dhe urdhëresat*, f. 44.

³³ *Krh*. Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 97.

³⁴ *Krh*. Gopčević: *Das Fürstentum Albanien*, f. 309.

³⁵ *Krh*. Po aty.

Skënderbeut, dhe u ofroi atyre në këmbim, të hartonin vetë një listë me të gjitha kushtet e favorshme që ata mund të kishin dëshirë. Drishtjanët iu përgjigjën atij se “me të vërtetë ia thoshte mendja atij të pushtonte një qytet të tillë me gjithë ato fjalë, kur Skënderbeu nuk qenkësh i zoti të pushtonte me armë në dorë një copë tokë çfarëdo? Dhe nëse ai e kishte vendosur, që me çdo kusht ta pushtonte Drishtin, atëherë le ta bënte këtë gjë me teshun e shpatës!” Hamzai u befusua shumë nga fjalët e tyre dhe ngaqë nuk kishte shumë besim në forcat e veta ushtarake u tërhoq dhe bëri kampin në një kodër një milje larg qytetit, dhe ra në një farë dëshpërimi pasi, nuk dinte se çfarë t’u bënte mureve të atij qyteti, pa artileri dhe mjete të tjera të nevojshme.

E gjithë ajo që kishte ndërmarrë kishte qenë pa plan dhe pa i menduar mirë gjërat. Aq më tepër atë po e inatosnin talljet e armikut që po e përqeshte pas shpatullave. Drishtjanët po shihnin nga sipër numrin e vogël të ushtrisë së Hamzasë, të paorganizuar, sepse shumë ushtarë të tij po bridhnin poshtë e përpjetë nëpër krahinë, që të mund të plaçkitnin ndonjë gjë. Nga kjo situatë ata morën zemër dhe vendosën, të dilnin nga qyteti, dhe ta sulmonin ushtrinë e tij drejt e në kamp. Autori i kësaj ideje ishte konti Andrea Engjëlli, i cili ishte fisnik dhe i përkiste parisë së qytetit, dhe njihej si një njeri që njihte artin ushtarak. Dhe kështu drishtjanët dolën me furi nga porta jugore e qytetit dhe nga britmat e tyre dhe të tjerëve mbi mure u krijua një zhurme e madhe, sa që ushtarët e Hamzait kujtuan se qenë të rrethuar nga një numër shumë i madh armiqsh. Megjithatë Hamzai nuk e humbi gjakftohësinë, por kërcëu mbi kalë dhe bashkë me disa të tjerë që ishin aty disi gati, kalëroi në drejtim të armikut që të mund t’i ndalte turrin, me qëllim që ushtarët e tij që ishin në kamp të kishin pak kohë dhe të organizoheshin në formacion luftimi. Por kjo manovër e Hamzait nuk solli ndonjë gjë, sepse ai ngaqë nuk mund t’i bënte ballë ushtrisë së Andrea Engjëllit, e cila ishte e ndarë në tre formacione, mori arratinë fill menjëherë pas ndeshjes së parë. Edhe trupat që kishin mbetur në kamp, pasi konstatuan se ishin pak, në krahasim me armikun që ishte më i shumtë në numër, ia mbathën nëpër fusha, duke ndjekur kështu shembullin e komandantit të tyre Hamzait. Andrea Engjëlli nuk deshi t’i ndiqte ata që po iknin dhe urdhëroi t’u binin borive për tërheqje, dhe i çoi forcat në qytet ku të gjithë kishin dalë t’i presin dhe t’i përgëzonin për këtë fitore. Porse ky gëzim u kthye pas pak kohe në vaj, sepse Hamzai, pasi mblodhi ushtrinë e vet, pa se me veprimet e tij kishte korrë me tepër turp sesa dëm; dhe ashtu siç ishte plot dëshpërim, për shkak të atij gjesti të poshtër që i kishte njollosur lavdinë e fituar nga fitoret e mëparshme, duke mos mund të hakmerrej kundër qytetit, shfryu kundër territoreve përreth. “Me atë krenarinë turke” shkoi në tërësi të shpatës zonat e banuara, u vuri flakën shtëpive, preu rrushin dhe ullinjë, pemë kjo që ishte e veçantë në atë vend;

shkatërroi me zjarr e me hekur çdo gjë që mund të dëmtohej, dhe deri sa u dogj e u shkrumbua çdo gjë përreth, nuk doli as edhe një drishtjan që të guxonte të dilte nga muret e qytetit për të luftuar, por të gjithë, si të penduar për fitoren e mëparshme po rrinin mbi mure të trishtuar e duke vajtuar po shihnin, se si po ju digjeshin pa pushim të mirat e tyre gjithkund përreth.”³⁶

Pas këtyre veprimeve Hamzai, iku nga krahina e Drishtit, dhe kalëroi me gjithë ushtri në drejtim të Dêjës. Në nëntor të vitit 1476 pati një komplot të organizuar nga një berber i qytetit, i cili synonte t’ia dorëzonte qytetin osmanëve, dhe ky komplot përmendet qoftë tek ditarët e Stefano Manjos (Stefano Magno), qoftë tek librat e Këshillit Venedikas.³⁷ Kur u vu re, se qytetit po i kërcënohej rrethimi turk, venecianët morën masa që ta furnizonin qytetin me ushqime dhe këtë e vërtetojnë shënimet e Manjos, si dhe aktet e Senatit Venedikas, dekretet e lëshuara prej të cilit mbajnë datën 8 dhjetor 1477, dhe për datën 16 shkurt gjemë një dekret të lëshuar njëzëri po nga ky senat, me anë të cilit miraton shtimin e furnizimit me drithë qoftë për Drishtin, qoftë për Shkodrën, pasi pranvera po vinte dhe bashkë me të edhe stina e fushatave ushtarake të osmanëve.³⁸

Kështjellës së Drishtit iu caktua edhe një komandat dhe qeveritar tjetër me emrin Nikolo Venier (Nocolò Venier), porse ky qeveritar nuk mundi të arrinte në qytet dhe posti i tij iu caktua Jakobo da Mostos (Jacobo da Mosto). Dhe ndodhi, që Drishti u pushtua nga osmanët në vitin 1478,³⁹ dhe gjatë rrethimit të fundit të Shkodrës osmanët sollën në kampin turk 300 drishtjanë të zënë rob, të cilëve sulltan Mehmeti II ua preu kokat të gjithëve para mureve të Shkodrës, me qëllim që t’ua fuste frikën shkodranëve dhe venedikasve brenda kështjellës, kështu që këta të

³⁶ *Krh.* Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*. Seconda Edizione. Brescia: Giammaria Rizzardi 1756, f. 124-128. (Cituar si: Biemmi: *Istoria*, f.).

³⁷ *Krh.* Schmitt, Oliver Jens, “Die venezianischen Jahrbücher des Stefano Magno als Quelle zur albanischen und epirotischen Geschichte im Späten Mittelalter (1433-1477)”, në *Südosteuropa*. Von Moderner Vielfalt und Nationalstaatlicher Vereinheitlichung. Festschrift für Edgar Hösch Hrsg. v. Konrad Clewnig und Oliver Jens Schmitt. München: Oldenburg 2005. (Südosteuropäische Arbeiten 127), f. 180. (Cituar si: Schmitt: “Die venezianischen Jahrbücher”. Në: *Südosteuropa*, f.).

³⁸ *Krh.* Po aty.

³⁹ Sipas Ermao Armanos Drishti ra në dorën e osmanëve në vitin 1477. *Krh.* Armano: *Vende, Kisha lumenj*, f. 73.

pranonin kapitullimin.⁴⁰ Marin Barleti na e përshkruan rrethimin dhe pushtimin e Drishtit, dhe ekzekutimin e qytetarëve të tij para mureve të Rozafatit si më poshtë.

“Ndërsa dorëzimi i Zhabjakut që me të vërtetë plot turp, përkundrazi drishtjanët dolën ma burra e ma të fortë: ata gjatë rrethimit të Shkodrës si ditën si natën e banë zakon të dilnin e të sulmonin në të katër anët stremet e barbarëve, repartet e kalorisë, turmat e deveve dhe të kafshëve të tjera që vlenin për bajtje me gjithë ushtarët e thjeshtë; i plaçkitnin dhe i banin rob. Shpesh u binin edhe shatorreve të anmikut, tue i shkaktue në këtë mënyrë kushedi se ç’dame të mëdha. Kur i arriti sulltanit në vesh kjo punë, u zemrua shumë dhe priti kohën që djelmoshat e Drishtit të dilnin nga qyteza, me qëllim ta shtinte ma lehtë edhe me datën 11 gusht dërgoi pashën e Azisë me të gjitha repartet e tija për të pushtue Drishtin. Pasha, mbasi ia preu shtegun repartit ma të fortë të krishterëve tu e lanë jashtë qytetit, vendosi artilerinë në pozicionet e duhuna dhe me të filloi të shembë muret e qytetit nga ajo anë në të cilën ledhet ishin ma të dobëta dhe mund të rrënoheshin ma me lehtësi. Mbas ledhet u rrafshuen për dhë brenda gjashtëmbëdhjetë ditëve, vetë sulltani me datën 31 gusht erdhi për të shti në dorë qytetin që do të merrej të nesërmen. Dhe me të vërtetë me 1 shtator, porsa zbardhi drita, u dha shenja edhe barbarët iu vërsulën nga të katër anët qytetit dhe iu futën brenda pa farë vështirësi, së pari sepse nuk pati kush ti përballonte e pastaj sepse muret e fortifikimet ishin shembë fare. Duhet dijtë se ajo këshjtjellë kishte një rreth të madh; mbasandaj të gjithë djelmoshat që mund të ishin nja tetëqind vetë (sikurse u tha ma nalt), kishin mbetë jashtë qytetit. Veç asaj, ata që ishin brenda në qytet dita e ditës dhetoreshin nga murtaja. Ata pak vetë që u orvatën m’e shporrë anmikun prej ledheve, u vranë e u prenë një nga një. U zunë të gjallë nja treqind vetë dhe me datë 2 shtator i çuen ndër shatorre; pastaj me urdhën të sulltanit të gjithë u vranë përnjëherë ndër sy të shkodranëve.”⁴¹

Pas pushtimit nga osmanët banorët e tjerë u lanë të lirë të iknin, dhe mesa duket shumica e tyre u vendos në territoret e Venedikut⁴², shtet ky që siç mësohet nga burimet e ndryshme u mundua t’i sistemonte sipas mundësive të ilurit nga Drishti (dhe nga qytetet e tjera të Shqipërisë

⁴⁰ *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 114.

⁴¹ Marin Barleci, *Rrethimi i Shkodrës*. Përkthyer prej origjinalit latinisht nga Henrik Lacaj. Botim i dytë i shtuar. Tiranë: Univ. i Tiranës 1967, f. 100. (Cituar si: Barleci: *Rrethimi i Shkodrës*, f. 100.).

⁴² *Krh.* Ippen, “Monumente ...”, në: *Shqipëria e Vjetër ...*, f. 183.

mesjetare). P. sh., më 10 dhjetor 1478 dogji i Venedikut Giovanni Mosenigo u shkruan ipeshkvit dhe kapitenit të Padovës, që këta t'u bënë një sistemim të përshtatshëm dy priftërinjve presbiter nga Drishti, duke theksuar edhe besnikërinë e këtij qyteti.⁴³ Sipas Ippenit, “në arkivin e Venedikut ekziston një listë e drivastinëve më të shquar, të cilët kishin shtegtuar në territoret veneciane”⁴⁴. Ndër emigrantët drishtjanë që u vendosën në Venedik mund të përmendim këtu Anjezë Sumën (Agneze Summa), e cila ishte gruaja e Prelepnos, “njërit nga të parët e Drishtit”⁴⁵ dhe pinjollë të tjerë të kësaj familje, pastaj edhe një listë me gra të veja nga Drishti të vendosura në Veneto, midis të cilave mund të përmendim “Zonjën Rouksa, të venë e Nikola Monetës, vojvodës së madh”, “zonjën Menega, të binë e Andrea Sakatos”, zonjën Marie të Drishtit (*Dona maria da Drivasto*) si dhe zonjën Buzica të Nikollës së Drishtit, së cilës ngaqë kishte mbetur e ve, do t'i jepeshin si ndihmë dy dukatë në muaj.⁴⁶ Këtu mund të përmendim edhe një farë Luca Spiron nga Drishti, i cili në vitet 1520 ishte prift i parë në kapitullin e kishës së Shën Jeremisë dhe më vonë i kishës së Shën Eufemisë në Guidecca.⁴⁷

Drishti ra si qytet, u rrënuar plotësisht duke pësuar fatin e shumë qyteteve të tjera që ndodheshin aty përreth, si Sardës, Sapës, Balezos Shasit, etj, dhe nuk u ripërtëri kurrë më.⁴⁸ Megjithëse në vitin 1614 Bolizza Drishtin e përshekruan si qytezë të fortifikuar, porse jo shumë të banuar,⁴⁹ kurse Gezzi Bianco në një relacion të vitit 1621 kalon nga Drishti, por nuk na jep asnjë informacion në lidhje me popullsinë aty,

⁴³ Krh. Lucia Nadin-Bassani, *Migrazione e integrazione: il caso degli Albanesi a Venezia (1479-1552)*, Roma: “Bulzoni” 2008, f. 50. (Cituar si: Nadin-Bassani: *Migrazione e integrazione*, f.).

⁴⁴ Ippen, “Monumente ...”, në: *Shqipëria e Vjetër ...*, f. 183.

⁴⁵ “*Agnese Summa, moglie di Prelepno, «tra i primi ti Drivasto»*” Nadin-Bassani: *Migrazione e integrazione*, f. 29.

⁴⁶ “*Dona Ruoxa, relicta quondam Nicolo Moneta el grando fu vojvoda, ...: Dona menega, fo fia de andra sachato ...; Dona busiza (altrove buxiaça) de nicolo da drivasto ... non aveva avuto provigione finché il marito era vivo, ora che è morto anche a lei spettera una provigione di due ducati al mese.*” Po aty, f. 25.

⁴⁷ Krh. Po aty, f. 127.

⁴⁸ Krh. Konstantin Jireček: “Albanien in der Vergangenheit”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 83. (Cituar si: Jireček: “Albanien”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f.).

⁴⁹ Krh. Armano: *Vende, Kisha lumenj*, f. 73.

veçse përmend Drishtin si dioqezë bosh (vakante), pra pa prani të krishterësh dhe kishash, dhe pa ipeshkëv.⁵⁰

Bashkësia e qytetit

Qyteti ishte i ndarë në pjesën e sipërme (qyteti i sipërm) dhe në pjesën e poshtme (qyteti poshtë), dhe kjo ishte tipike për qytetet e atëhershme shqiptare dhe një ndarje të tillë e gjemë edhe në qytetet Tivar, Danjë, Durrës dhe pjesërisht edhe në Shkodër dhe në Lezhë.⁵¹ Porse organizimi i bashkësisë së qytetit (*communitas*), aktet e të cilit përpiloheshin nga një noter, i cili ishte prift, është akoma i panjohur.⁵² Bile në lidhje me noterët e Drishtit, duhet të shtohet këtu që këta, ishin presbiter vendas, ndryshe nga Shkodra ku kishte noterë laikë dhe nga Tivari dhe Ulqini, ku noterët ishin italianë.⁵³

Në Drisht popullsia e qytetit përbëhej kryesisht nga dy bashkësi me etni të ndryshme, një bashkësi romane⁵⁴, e cila me sa duket përbënte pjesën më të madhe të popullsisë, dhe një bashkësi shqiptare, e cila ishte mjaft e fortë, dhe duhet të theksohet këtu që emri i sotëm “shqiptar” përmendet për herë të parë në Drisht në vitin 1368, si mbiemër familjar.⁵⁵ (1368 gjurma e parë e emrit të popullit shqiptar [*Presbyter Petrus Schepudar, Canonicus Drivastensis*]⁵⁶). Duket se midis qytetarëve me etni shqiptare dhe shqiptarëve të cilët jetonin si barinj dhe blegtorë dhe bënë një jetë pothuajse seminomade ekzistonte një dallim, pasi me fjalën “albanenses” nënkuptoheshin këta të fundit, dhe kriteret për t’i dalluar këta si “albanenses” ishin gjuha dhe mënyra e ekonomisë së tyre.⁵⁷ Pra siç e thamë edhe më lart dhe siç na informon edhe Marin Barleti, qytetarët e Drishtit e mbanin veten me krenari si pasardhës të romakëve

⁵⁰ Fulvio Cordignano, “Geografia Ecclesiastica dell’ Albania. Dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII”, Roma: Pont. Institutum Orientalium Studiorum, në: *Orientalia Christiana*. Vol. XXXVI.-4. Num. 99/ Decembri 1934, f. 15. (Cituar si: Cordignano: *Geografia Ecclesiastica*, f. 15.)

⁵¹ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 98.

⁵² *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 113.

⁵³ *Krh.* Statutet dhe urdhëresat, f. 62.

⁵⁴ *Krh.* Šufflay: *Städt und Burgen Albaniens*, f. 26; *krh.* Jireček, “Albanien”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 68.

⁵⁵ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 51. Referencë 59.

⁵⁶ *Krh.* Pëllumb Xhufi: *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*. Tiranë: Pegi 2006, f. 27. (Cituar si: Xhufi: *Dilemat e Arbërit*, f.).

⁵⁷ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 51. Referencë 59-60.

(*Romanorum colonos se appellantes*) dhe sipas Shufflait dhe Novakut në emrat familjarë aty midis në periudhën midis shekujve XIV – XV, gjejmë mjaft nga to që janë emra romanë: *Palombo* ose *Colomba**, *de Leporibus**, *Barbabanca**, *Summa, Bello*; por krahas këtyre ka edhe mbiemra shqiptarë si: *Bariloth, Precalo, Scapuder*; dhe mbiemra serbë si: *Beroj, Svinja (de Svinis, Suignis, Grinçarius (Presbyter Domenicus Grinçarius de Drivasto))*⁵⁸ ose grekë, si: *Calageorgii* dhe *Spano (σπανος - pa mjekër)*. Familja më e ngritur fisnike ishte ajo e quajtur me mbiemrin *Span* ose *Spano*, serbisht *Spanovići*. Një linjë e kësaj familjeje ka qenë në shërbim të venecianëve gjatë shek.XV, kurse një linjë tjetër u përkiste përkrahësve të serbëve.⁵⁹

Në lidhje me këtë Ippenit përmend një farë Andreas Shpani, i cili mesa duket ishte një vasal i mbretit serb Stefan Dushani, dhe pas vdekjes së këtij bëhet sundues i Drishtit.⁶⁰ Shpanët ishin me origjinë nga Shkodra dhe ngaqë merreshin me tregti arrijnë të blejnë toka në Drisht, dhe mesa duket vendosen atje përfundimisht.⁶¹ Nga kjo familje e ka origjinën Pjetër Shpani, kanonik i Drishtit, i cili më vonë bëhet kryeipeshkv i Tivarit.⁶² Një përfaqësues tjetër i kësaj familje, i cili përmendet edhe në librat e arkivave të Raguzës, po me emrin Pjetër Shpani (Peter Span),

* Në lidhje me mbiemrat familjarë në gjuhën latine mund të thuhet këtu, që në Mesjetë (sidomos gjatë periudhës venedikase) ishte e “modës”, që emrat të shkruhen në formë latine dhe të përkthehen në atë gjuhë, p.sh.: *Angelus* (Engjëlli), *Barletius* (Barleci), etj, etj; dhe si rrjedhim në lidhje me origjinën etnike të disa familjeve është nganjëherë e vështirë të thuhet sot, nëse ato ishin latinë, shqiptarë apo diçka tjetër, kështu që edhe mbiemri *Palombo* ose *Colomba* (shqip *pëllumbi*) korrespondon shumë me mbiemrin familjar shqiptar *Pëllumbi* – E. M.

* “*De leporibus*” duket se ka ngjasim me fjalën shqipe “*lepuri*”, por mund të jetë edhe rasa rrjedhore shumë e emrit *Lepos, leporis* (dhan. *Leporibus*; rrjedh. *De leporibus*), që do të thotë *hijeshi, bukuri*, dhe si rrjedhim ky mbiemër familjar mund të përkthehet në shqip me “prej të hijshmëve ≈ i të hijshmëve, i të bukurve”. – E. M.

* *Barbabanca* = Mjekërbardhi, edhe ky mbiemër për shkak të formës së tij të përbërë (*barba + bianca* = mjekër + bardhi), më ngjason edhe me formën e mbiemrave të përbërë familjarë shqiptarë (si p.sh: *Kryeziu, Kokëdhima, etj, etj.*), pra nuk tregon medoemos një identitet etnik latin. – E. M.

⁵⁸ *Krh. Statutet dhe urdhëresat*, f. 46.

⁵⁹ *Krh. Jireček, “Skutari”, në: Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 113.

⁶⁰ *Krh. Ippen, “Monumente ...”, në: Shqipëria e Vjetër ...*, f. 182.

⁶¹ *Krh. Statutet dhe urdhëresat*, f. 47.

⁶² *Krh. Po aty.*

1430-1456 († para vitit 1458) ishte shqiptar katolik.⁶³ Ai kishte tre bij: Bozhidar (Božidar) († para vitit 1474), Aleksin (Alexius filius Petri Spani = Aleksi, i biri i Pjetër Shpanit – E. M.) ose të quajtur ndryshe edhe Llesh Shpanoviqin (Lješ Spamović), i cili në vitin 1454 ka qenë vojvodë i despotit Gjergj (Georg) në qytetin malor të Novo Bërdës (Lleshi në vitin 1474 ka qenë gjallë akoma) dhe biri i fundit i Pjetër Shpanit quhej Hërvoje (Hrvoje) që në vitin 1478 ishte akoma gjallë.⁶⁴ Ky Pjetër Shpani mori pjesë edhe në Lidhjen e Lezhës (1444), kreu i së cilës u bë Skënderbeu.⁶⁵ Në vitin 1474 paraqiten edhe i biri i Bozhidarit, Pjetri me nënën e tij Gojsavën dhe gruan e tij Ljubosavën.⁶⁶

Një familje tjetër me rëndësi në Drisht ishte edhe familja Ungaro, e cila me sa duket ishte me origjinë nga Kotorri, por ndoshta edhe nga ndonjë qytet tjetër dalmatin, dhe prej kësaj familje vinte Paulus Ungaro, fisnik i Drishtit (*Nobilis de Drivasto, 1403*), i cili qe nderuar me medalje për luftën kundër osmanëve. I biri i tij ishte me sa duket Bellazzo (Bellacisu) Ungaro, që pati shumë merita për kalimin e Drishtit dhe të Tivarit nën sundimin venedikas.⁶⁷ Atij si shpërblim 1443 iu fal fshati *Gastropoti* dhe emërohet më vonë edhe *Vojvodë i Drishtit* dhe përfaqësonte qytetin e tij në Venedik që prej 20 korrikut 1446.⁶⁸ Pas vdekjes së tij Venediku emëron birin e tij Nikollën si vojvodë të Drishtit.⁶⁹ Një pinjoll i kësaj familje ishte edhe Marino Ungaro, që përmendet në vitet 1508-1514 si rektor i juristëve në Universitetin e Padovës.⁷⁰

Një tjetër familje me rëndësi ishte edhe ajo me mbiemrin *Lepore* (*de Leporibus*) prej kësaj familje vinte edhe një person tjetër me emrin Gjjon që ka qenë ipeshkëv i Drishtit nga viti 1360 deri në vitin 1373 (sipas Shuflait dhe Novakut qe ipeshkëv gjatë kohës 1359-1389⁷¹), dhe

⁶³ *Krh. Jireček, "Skutari", në: Illyrisch-Albanische Forschungen I, f. 113.*

⁶⁴ *Krh. Po aty.*

⁶⁵ *Krh. Statutet dhe urdhëresat, f. 47.*

⁶⁶ *Krh. Jireček, "Skutari", në: Illyrisch-Albanische Forschungen I, f. 113.*

⁶⁷ *Krh. Statutet dhe urdhëresat, f. 48.*

⁶⁸ *Krh. Po aty.*

⁶⁹ "*vidua Nicolai Ongaro condam vojvode de Drivasto*" Šufflay: *Städt und Burgen Albaniens*, f. 54. Ref. 57.

⁷⁰ *Krh. Nadin-Bassani: Migrazione e integrazione, f. 93.*

⁷¹ *Krh. Statutet dhe urdhëresat, f. 61.*

më pas papa Gregori XI e transferoi atë në arqipeshkvinë e Tivariit.⁷² Ky ipeshkëv ishte i lidhur shumë me Balshajt.⁷³ Një person tjetër i njohur i kësaj familjeje ka qenë Teodori i Drishtit (*Teodorus de Drivasto*) i cili qe ndihmës i Dominik Topisë (xhaxhait të princit të njohur, Karl Topisë), i cili u mundua të bëhej kryeipeshkv i Raguzës dhe që ishte shumë aktiv në instalimin e urdhrin domenikan në trojet shqiptare dhe në ndërtimin e kuvendeve dominikane në Shkodër, Kotorr dhe Shibenik dhe që në vitin 1367 u bë kryeipeshkv i Zarës.⁷⁴ Teodori që njihej si ndihmës dhe përkrahës i Dominik Topisë u dëbua nga qeveria e Raguzës, porse me kërkesën e Balshajve, këshilli i lartë i Raguzës më 4 maj 1361 i lejoj atij që të qëndronte atje edhe katër muaj, me arsyetimin se atij i duhej të mblidhte borxhet që i kishin qytetarët e atjeshëm.⁷⁵ Teodori kishte lidhje



Fig. 3. Rrënojat e kështjellës të fotografuara nga poshtë, tek fshati i vjetër i Drishtit. Foto: E. Malaj

gjaku me ipeshkvin e Drishtit, Gjonin që përmendëm pak më lart.⁷⁶

Në lidhje me zanatet aty dukej se ishte e zhvilluar kryesisht poçeria, kovaçanat, përpunimi i mëndafshit⁷⁷ dhe sidomos punimi me gurë⁷⁸. Një degë e rëndësishme e ekonomisë së Drishtit, duhet të ketë qenë vreshtaria dhe prodhimi i verës, që duhet të

⁷² *Krh. Illyrici Sacri*. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletio olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004.), f. 237. (Cituar si: Farlato: *Illyrici Sacri VII*, f.)

⁷³ *Krh. Šufflay: Stadt und Burgen Albaniens*, f. 52.

⁷⁴ *Krh. Statutet dhe urdhëresat*, f. 60-61.

⁷⁵ „[...]quod Theodorus de Leporibus de Drivasto possit stare in Ragusa ad exigendum debita sua.“ Po aty, f. 61.

⁷⁶ *Krh.* Po aty.

⁷⁷ *Krh. Fjalor Enciklopedik Shqiptar*. Botuar nga Akademia e Shekncave të RPS të Shqipërisë Tiranë 1985, f. 209. (Cituar si: *Fjalor enciklopedik shqiptar*, f. 209.)

⁷⁸ *Krh. AAlb. II*, nr. 747, f. 229.

ketë qenë i rregulluar me ligje të veçanta të statutit.⁷⁹ Në zonat përreth kishte mjaft verë (rrush – E.M.) dhe vaj (ullinj – E.M.), porse luftërat e pandërprera e kishin rritur vazhdimisht mjerimin dhe gjendjen e vështirë në qytet.⁸⁰ Sot po në ato zona përreth nuk ka asgjë më, vetëm kodra shkëmbore të mbuluara pjesërisht me ferra e shkurre.

Qyteti i Drishtit shtypte edhe monedha bakri; mbi këto monedha ishte e stampuar ikona e Shën Mërisë dhe mbi disa të tjera një qytet me kulla dhe me një portë mbi të cilën ishte i skalitur një zambak, kurse mbishkrimi “*civitas Drivasti*” (qyteti i Drishtit), sipas një monedhe të gjetur, nuk mund të lexohej qartë, kurse në anën tjetër të monedhës paraqiteshin muret e qytetit.⁸¹ Përsa i përket administratës së qytetit, deri tani dimë se ka pasur *vojvodën* (që e përmendëm më sipër), që kishte të bënte kryesisht me “policinë e qytetit” dhe ishte kreu i saj, por që kishte edhe funksione të tjera në organizimin komunal të qytetit, pastaj dhe *podestas* (*podesta*), që në shqip do të thotë “zot, kapiten, njeri me pushtet të plotë në një zyrë të caktuar.” dhe duket se ky post njihet edhe me emërtimin “*castellanus Drivasti popularis*”⁸².

Për arsye kursimi në vitet 1397-1399 venedikasit ia caktuan këtë detyrë një njeriu jo fisnik, kastellanit të dukës së Shkodrës, dhe kjo gjë shkaktoi pakënaqësi të mëdha tek qytetarët e Drishtit.⁸³ Si rrjedhim, Kastelani u caktua pësëri nga Drishti, por që duhej të ishte sërish nën urdhërat e kapitenit (*comes*) të Shkodrës.⁸⁴ *Podestati* i Drishtit duhej të ishte i pranishëm në “gjykatë”, pra në proceset gjyqësore çdo të hënë, të martë dhe të premte gjithë ditën, kurse për çdo të mërkurë dhe të enjte pas ngrënies së drekës, dhe apelimi ndaj vendimeve të tij në çështjet civile prej viti 1444 e më pas duhej të bëhej në Shkodër dhe nëse bëhej fjalë për çështje me shuma mbi 100 dukatë, apelimet bëheshin në Venedik.⁸⁵ Rroga e këtij zyrtari për qytetin e Drishtit ishte për vitet 1396-

⁷⁹ *Krh. Schmitt: Das venezianische Albanien*, f. 118.

⁸⁰ *Krh. Jireček, “Skutari”, në: Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 113.

⁸¹ *Krh. Statutet dhe urdhëresat*, f. 45.

⁸² *AAlb. II*, nr. 596, f. 167.

⁸³ *Krh. Šufflay: Städt und Burgen Albaniens*, f. 54. *Krh. edhe AAlb. II*, nr. 596, f. 167.

⁸⁴ “[...] *et sit ad omnem obedientiam comitis Scutari.*” *AAlb. II*, nr. 596, f. 167.

⁸⁵ *Krh. Šufflay: Städt und Burgen Albaniens*, f. 54.

1399 tetë dukatë ari në muaj, dhe që duhej të mbante me shpenzimet e tij edhe një ndihmës a asistent.⁸⁶

Siç e përmendëm edhe më lart, Drishti si shumë qytete shqiptare të Mesjetës (p.sh. si Tivari, Durrësi, Deja) ishte i ndarë në pjesën e sipërme dhe pjesën e poshtme të qytetit. Në pjesën e sipërme ishte kalaja e fortifikuar e cila shërbente si administratë e qytetit dhe gjykatë kurse pjesa e poshtme ishte vendi i banimit me treg, me lagjen e zejtarëve dhe me zonën e kopshtijeve,⁸⁷ porse duhet të theksohet këtu që këshilli i qytetet nuk kishte një godinë të vetën dhe ndoshta mblidhej në ndonjë kishë, siç bëhej edhe në Shkodër.⁸⁸ Përveç këshillit, në qytet luanin një rol të rëndësishëm edhe gjykatësit (iudices), të cilët ushtronin edhe pushtet ekzekutiv dhe përfaqësonin qytetin edhe jashtë tij.⁸⁹ Krahas ndërtesave të thjeshta, në Drisht duket se ka pasur edhe shtëpi të larta deri në katër kate.⁹⁰ Në vitin 1404, në Drisht, venecianët ndërmorën edhe ndërtimin e rezervuarëve dhe të cisternave të ujit, të cilët mesa duket, më parë nuk kishin ekzistuar, jo vetëm në Drisht, por as në Shkodër dhe as në Durrës.⁹¹

Sipas M. Ahmetit dhe E. Lalës “të huajt nuk ishin të mirëpritur në Drisht, sidomos në shekullin e katërmëdhjetë por edhe më vonë”⁹². Kështu që në shek.XV, të huajt me funksione në qytet, u zëvendësuan plotësisht me klerikë vendas, të cilët vinin nga familjet fisnike vendase dhe ky fenomen nuk ndodhi vetëm në Drisht por edhe në qytetet e tjera shqiptare.⁹³

Shenjtji mbrojtës i Drishtit ishte Shën Gjergji dhe festa e Shën Gjergjit shënonte pikën kulminante në jetën e qytetit. Gjatë kësaj feste të huajt gëzonin bile edhe të drejta mbrojtëse të veçanta⁹⁴. Përveç festimit në masë të gjerë të një Shenjtorit, në Drisht ashtu si në qytetet e tjera shqiptare, sidomos në ato veriore të rritit roman, ekzistonin edhe të

⁸⁶ “[...] fiat annus castellanus Drivasti popularis, qui habeat de salario in mense ducatos octo auri et tenere debat suis expensis unum famulum [...]” AAlb. II, nr. 596, f. 167.

⁸⁷ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 98.

⁸⁸ *Krh.* Po aty, f. 100.

⁸⁹ *Krh.* Po aty, f. 120.

⁹⁰ *Krh.* Po aty, f. 101.

⁹¹ *Krh.* Po aty, f. 70.

⁹² *Statutet dhe urdhëresat*, f. 22.

⁹³ *Krh.* Po aty.

⁹⁴ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 132.

ashtuquajturat “vëllazëri” (*fratalia, fraternitas*) dhe “shkollat” (*scuole*), të cilat mesa duket ishin të ngjashme me “vëllazëritë” dhe “shkollat” e tipit italian, që përbëheshin nga një numër i kufizuar anëtarësh, të cilët mbledheshin së bashku për të nderuar një shenjtor të veçantë⁹⁵. Për Drishtin njihen “vëllazëritë” e Shna Kryqit, Shën Gjergjit dhe Shën Mërisë. Ndoshta këto “vëllazëri” luanin edhe rolin e korporatave, porse korporata të mirëfillta, në të cilat organizoheshin zejet, të paktën deri në shek.XIV dhe gjatë tij, duket se nuk ka pasur.⁹⁶ Në lidhje me shkollat, nuk dimë asgjë, nuk kemi asnjë informacion se çfarë tipi ishin, çfarë mësohej në to dhe se cili ishte aktiviteti i tyre, por nga Drishti kanë dalë dijetarë, të cilët janë bërë ipeshkvij në provinca të ndryshme, kanë hapur edhe shkolla dhe kanë qenë noter edhe jashtë vendit (p.sh. Dalmaci).

Për shembull në vitin 1388 në Raguzë përmendet një drishtjan (drivastin), me emrin Teodor, i biri i Nikollës, i cili kishte hapur një shkollë fillore në lokalitetin e quajtur Stanjo (Stagno) të kësaj republike (pra të Raguzës), dhe që u mor vendim t’i jepeshin 10 perperë për pagesën e qirasë së shtëpisë, ku kishte hapur shkollën.⁹⁷

Ipeshkvia e Drishtit

Drishti njihet si ipeshkvi që në fund të shek.IX, por fatkeqësisht deri më sot nuk kemi arritur të kemi një histori të plotë të kësaj qendre ipeshkvnore dhe informacionet më të shumta rreth saj i kemi deri tani nga jezuiti italian, historiani i njohur i kishës, Daniele Farlati, i cili ishte në fillim bashkautor dhe pastaj autor kryesor i veprës monumentale prej 12 vëllimesh, me titull “*Illyricum Sacrum*”, ku përshkruhet historia e kishës katolike në Dalmaci, Shqipëri dhe pjesërisht deri në Epir. Kësaj vepre do t’i referohemi kryesisht në nënçështjen, në të cilën bëhet fjalë për ipeshkvit e kësaj ipeshkvie. Sipas Shuflait, Drishti i përket “shtresës së dytë” të krijimit të ipeshkvive shqiptare, shtresë kjo që e ka zanafillën në gjysmën e parë të shek.VIII dhe vazhdon deri në mesin e shek.XIII.⁹⁸

⁹⁵ *Po aty..*

⁹⁶ *Krh.* Po aty, f. 133.

⁹⁷ “1388, 19 Decembris, Ragusii. Drivastinus Stagni scholam aperit. I eodem consilio minore captum fuit, quod dentur yperperi X Teodoro filio d(omi)ni Nicole de Driuasto peo affictu domuz, in qua debet tenere scolares in Stagno, pro docendo (!) eos legere et scribere” *AAlb. II*, 435, f. 105.

⁹⁸ *Krh.* Milan von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme”. Në: *Illyrisch-Albanische*

Në katalogët më të vjetër të peshkopëve grekë, Drishti o *Δριβαστου* □përmendet nën juridiksionin e mitropolitit të Durrësit; kurse nga shek.XI ishte nën juridiksionin e arqipeshkvit katolik të Tivarit⁹⁹ e vënë nga Papa Aleksandri II, sipas Dëllingerit (Döllinger) në vitin 1062.¹⁰⁰ Por këtu ka një pasaktësi, sepse sipas Schmittit, Tivari u bë ipeshkvi në vitin 1089.¹⁰¹ Kurse, në fund të shek. XII, Drishti i përkiste kryepeshkvisë së Pultit.¹⁰² Ipeshkvia e Drishtit erdhi gjithnjë duke u rritur sa që në shek.XIV, Drishti kishte shumë kisha dhe nga studiuesit konsiderohet se ka qenë një ndër fidanishtet më të mëdha të klerit katolik shqiptarë, krahas Shasit (Saucium).¹⁰³ Kishat e Drishtit ishin me mure të trasha¹⁰⁴ dhe deri më sot dimë se ky qytet kishte këto katedrale dhe kisha:

- *Katedralja e Shën Mërisë* (përmendur në vitin 1352) (*capitulum ecclesiae S. Mariae de Drivasto 1352*), e cila kishte edhe një shkollë.¹⁰⁵ Bile kulti i Shën Mërisë ishte aq shumë i rëndësishëm, saqë ikona e Shën Mërisë ndodhej edhe në monedhat e këtij qyteti.

- *Katedralja e Shën Gjergjit* (1400), e cila kishte edhe një shkollë.
- *Kisha e Shën Kryqit*, e cila, sipas burimeve kishte edhe një shkollë.
- *Kisha e Shën Stefanit*
- *Kisha e Shën Françeskut* (1404)
- *Kisha e Sancta Maria Veteris* (1403)
- *Kisha e Shën Shelbuemit* (1399)
- *Kisha e Shën Prendës* (Shna Prendes) (1400)

Forschungen. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [usw.]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 194-195. (Cituar si: Šufflay: “Kirchenzustände”. Në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f.).

⁹⁹ *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 111.

¹⁰⁰ *Krh.* Ignaz von Döllinger: *Beiträge zur politischen, kirchlichen und cultur-geschichte der sechs letzten Jahrhunderte*. Regensburg: Veröffentlicht von Georg Joseph Manz 1863, f. 93.

¹⁰¹ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 86.

¹⁰² *Krh.* Po aty, f. 51.

¹⁰³ *Krh.* Statutet dhe urdhëresat, f. 48.

¹⁰⁴ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 99.

¹⁰⁵ “[...] ut nostra ecclesia cathedralis et ecclesia S. Georgii et tres scole maiores videlicet S. Crucis, S. Georgii, S. Marie sint exempte ab onere decimarum prout antea fuerunt.” Statutet dhe urdhëresat, f. 55.

• *Kisha e Shënkollit* (S. Nicolaus) në varoshin e vjetër.¹⁰⁶

Sipas Jireçekut, midis qytetit dhe kështjellës ndodheshin rrënojat e një kapele të vogël me tre altarë të rumbullakët.¹⁰⁷

Nën malin Maranai që në shek.XV quhej edhe Marinaa ose Marinay shtrihej manastiri benediktin i Shën Gjonit, që në vitin 1356 u vu nga Papa nën juridiksionin e ipeshkvit të Balcit, kurse më vonë ky manastir, i ndodhur në vendin e quajtur Stole apo Strilalio, i përkiti krahinës së Drishtit dhe abati i manastirit duhej të ishte gjithmonë një drishtjan (*semper in futurum abbas sit Drivastinus*).¹⁰⁸ Rrënojat e këtij manastiri, sipas Jireçekut, një kullë katërkëndëshe me mbetjet nga kisha dhe nga ndërtesat e manastirit ndodhen në fushën e quajtur Shtoj, në veri të Shkodrës, tek fshati Rasha (Raši).¹⁰⁹

Tek ipeshkvi i Drishtit kishte shumë klerikë, famuj dhe priftërinj të rangut të lartë; p.sh. në vitin 1317, përmendet një prift nga Drishti, i quajtur Andreas de Drivasto (1317-1334) që ishte noter në Ishullin Lagosta, i cili i përkiste shtresës së patricëve ulqinakë.¹¹⁰ Për vitin 1349, gjatë së cilit në Drisht ra sëmundja e murtajës, në Raguzë përmenden në librat e notariatit, 7 priftërinj vetëm nga Drishti (për këtë vit përmenden gjithsej 24 priftërinj shqiptarë) që përveç shërbimeve të ndryshme, sidomos të noterisë, merrnin përsipër edhe udhëtimet nëpër vendet e ndryshme të pelegrinazhit si p.sh. për në Monte Gargano, Bari, Santiago de Kompostella, Asizi, Rom, etj.¹¹¹ Kurse në vitin 1399, për shkak të rrezikut turk, në Raguzë pati një koloni të madhe priftërinjsh nga Drishti.¹¹²

Siç duket pra ky qytet kishte shumë priftërinj dhe këta detyroheshin të bënin aty edhe shërbime të ndryshme komunale angarie, siç ishte p.sh. edhe shërbimi i rojës së qytetit, dhe këtë gjë e vërteton edhe një vendim i

¹⁰⁶ “*Ego quidem presbyter Nicolaus de Driuasto legiptimus presbyterorum sancte Marie de Driuasto[...]*” AAlb. II, nr. 99, f. 28; “*Sub Driuasto apud ecclesiam S. Nicolai sub civitate Veteri*”. Po aty, f. 43; *krh.* Aleksandër Meksi: *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (Shekujt VII-XV)*, Tiranë: Eugen 2004, f. 142-143; *krh. edhe* Armao: *Vende, kisha lumenj*, f. 73.

¹⁰⁷ *Krh.* Jireček, “Skutari”, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 111.

¹⁰⁸ *Krh.* Po aty, f. 114.

¹⁰⁹ “Në shek.XIX, në lidhje me rrënojat e manastirit të Shën Gjonit të Rashit pati ngatërresa të mëdha midis katolikëve dhe të ardhurve ortodoksë nga Mali i Zi.” Po aty.

¹¹⁰ *Krh.* Šufflay: *Städt und Burgen Albaniens*, f. 78.

¹¹¹ *Krh.* Šufflay: “Kirchenzustände”. Në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 265.

¹¹² *Statutet dhe urdhëresat*, f. 48.

Senatit të Venedikut për vitin 1397.¹¹³ Ky numër i lartë i klerit e kishte bërë Drishtin të njihej si “qytet ... eksportues priftërinjsh”¹¹⁴. Kisha Katedrale e ipeshkvisë së Drishtit kishte edhe “statutet e saj”, të përbëra prej 53 (LIII) kapitujsh, nëpërmjet të cilave rregullohej jeta dhe veprimtaria e klerit aty. Ekzistenca e tyre bëhet e njohur në vitin 1392.¹¹⁵ Këto statute ishin zakonore dhe të vjetra dhe këtë e nxjerrim nga teksti i tyre.¹¹⁶ Dorëshkrimi është i shkruar nga kanoniku dhe noteri i Tivarit, Simeon Dromasus më 12 janar 1468.

Ipeshkvit e Kishës së Drishtit nga shek. IX deri në shek. XVII

Për të dhënat mbi ipeshkvit e Drishtit, i jemi referuar vëllimit të shtatë të veprës së Farlatit “Illyricum Sacrum”, e cila na jep informacione të shumta në lidhje me këta ipeshkëv. Interesant është fakti që emërimi i ipeshkviëve u bë edhe pasi qyteti u pushtua nga osmanët në vitin 1478 e më vonë. Lista e ipeshkve të Drishtit vijon si më poshtë:

I. Emri i ipeshkvit i panjohur, viti 877

Në vitin 877 u zhvillua edhe një koncil i ashtuquajtur “Koncili Delmitan” (Concilium Delmitanum) ku morën pjesë edhe të gjithë ipeshkviët e Provincës kishtare të Dioklesë, dhe aty Kisha e Drishtit u bë ipeshkvi, duke u renditur si sufragane e mitropolisë së provincës së lartpërmendur.¹¹⁷ Pra Kisha e Drishtit pati nga ky vit ipeshkvin e vet, porse emri i këtij nuk dihet dhe nuk njihen as emrat e ipeshkviëve të tjerë duke filluar nga viti 877 deri në vitin 1062, sepse për gati dyqind vjet rresht, nuk ka asnjë farë informacioni në lidhje me këtë ipeshkvi.¹¹⁸

¹¹³ „*faciant custodias et alias angarias tamquam seculars ... sicut fecerunt hucusque.*” Šufflay: “Kirchenzustände”. Në: *Illyrisch-Albanische Forschungen I*, f. 265.

¹¹⁴ Xhufi: *Dilemat e Arbërit*, f. 243.

¹¹⁵ *Krh.* Schmitt: *Das venezianische Albanien*, f. 96, 110.

¹¹⁶ *Krh.* “Statutet dhe urdhërat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit”. Në: *Gjurmime Albanologjike*. Seria e Shkencave Historike 1-1971. Prishtinë 1972, f. 188. “*antiquissima et observata consuetudine secundum morem et consuetudinem antiquorum.*” Kap. 46.

¹¹⁷ *Krh.* Farlati: *Illyrici Sacri VII*, f. 234.

¹¹⁸ “*Post hunc anonymum Episcopum anni fere docenti interfuere, cum Ecclesiae & Episcopi nulla mentio, nullum indicium repetitor.*” Po aty.

II. Emri i ipeshkvit i panjohur, viti 1062

Edhe për vitin 1062, emri i ipeshkvit të Drishtit nuk dihet, por është e sigurt që në këtë vit Kisha e Drishtit e kishte akoma titullin e ipeshkvisë. Këtë e marrim vesh nga letrat e papë Aleksandrit II dërguar *Pjetrit, kryeipeshkvit të Kishës së Dioklesë dhe të Tivarit*, me datë 18 mars 1067, në të cilat krahas ipeshkve të tjerë dalmatin, vë në listë dhe i vendos nën juridiksionin e këtij kryeipeshkvi edhe ipeshkvin e Drishtit,¹¹⁹ por pa i përmendur emrin, nga kjo del se Drishti edhe këtë vit ka pasur peshkopin e vet.¹²⁰ Këtë e rikonfirmon pastaj pothuaj tridhjet vjet më vonë (8 janar 1089) edhe Papa Klementit III, duke e përmendur edhe ipeshkvinë e Drishtit si sufragane të këtij kryeipeshkvi, pra të “*Petro Dioclenensis sedis archiepiscopo*”¹²¹. Pas këtij ipeshkvi anonim, që tek Farlati është i dyti, kemi një ndërprerje në listën e ipeshkvijve të Drishtit deri në vitin 1122.

III. Emri i ipeshkvit i panjohur (ndoshta Elia), viti 1122

Papa Kaliksti II në një letër të datës 14 tetor të vitit 1122 e deklaroi kishën e Drishtit si Sufragane të Arqipeshkvisë së Raguzës me arqipeshkvijtë raguzinë të Dioklesë dhe të Tivarit Geraldus por nuk përmend emrin e ipeshkvit të Drishtit.¹²²

IV. Pjetri, Ipeshkëv i Drishtit (*Petrus Episcopus Drivastensis*), vitit 1141

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1141, por nuk pati sukses në detyrën e tij, sepse në vitin 1153 i dërguari apostolik Henrikus e hoqi nga

¹¹⁹ “*Alexander II. papa “Petro venerabili archiepiscopo Diocliensis atque Antibarensis ecclesiae” “Dioclensem ecclesiam cum omnibus suis pertinentiis”, Antibarensensem, Ecaterensem, Palachiensem (!), Suatinensem (!), Drivastinensem, Polatinensem, Serbiensem, Bosoniensem, Tribuniensem ecclesiam, “monasteria quoque tam Latinorum quam Graecorum sive Sclavorum” subicit.” Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen., nr. 63, f. 17. (Cituar si: AAlb. I, nr. i dokumentit, f.).*

¹²⁰ “*Queppe Alexander II. in suis ad Petrum Archiepiscopum Dioclenensis Ecclesiae litteris cum aliis Dalmatiæ superioris Episcopis Dinnastriensem, idest Drivastrastensem eidem adscriptis: quod argumento est, sum illi non defuisse Episcopum; sed humus nomen ingnotum est.*” Farlati: *Illyrici Sacri VII*, f. 234-235.

¹²¹ *Krh. AAlb. I*, nr. 68, f. 21.

¹²² *Krh. Farlati: Illyrici Sacri VII*, f. 235. *Krh. AAlb. I*, nr. 81, f. 27. (Tek AAlb., emrin ipeshkvi e ka Elia).

postit i ipeshkvit dhe po ashtu veprimi edhe me Gjonin (Joannem) Ipeshkvin e Ulqinit, dhe i mallkoi që të dy. Ai i thirri këta të dy të paraqiteshin në sinodin provincial, të organizuar nga ai vetë në Raguzë, por këta nuk u paraqitën.¹²³ Pas Pjetrit Ipeshkvia e Drishtit nuk pati ipeshkëv deri në vitin 1166.

V. *Martinus, Ipeshkëv i Drishtit (Martinus Episcopus Drivastensis), viti 1166*

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1166, mesa duket qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 1178, pasi në këtë vit u vendos në Tivar, por jo si ipeshkëv.¹²⁴

VI. *Petrus II, Ipeshkëv i Drishtit (Petrus II Episcopus Drivastensis), viti 1199*

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1199, dhe nuk e dimë se deri kur qëndroi në këtë detyrë.¹²⁵

VII. *Emri i ipeshkvit i panjohur, viti 1220*

VIII. *Emri i ipeshkvit i panjohur, viti 1250*

IX. *Dominikus, Ipeshkëv i Drishtit (Dominicus Episcopus Drivastensis), viti i panjohur*

Emri nuk është i sigurtë. Nuk dihet se në cilin vit u bë ipeshkëv dhe vdiq më 1322.¹²⁶

X. *Nicolaus, Ipeshkëv i Drishtit (Nicolaus Episcopus Drivastensis), viti 1322*

Nikolaus ishte i urdhrit të fetërve eremitë të Shën Augustinit. U zgjedh si ipeshkëv i Drishtit në vitin 1322 por për shkak të disa mosmarrëveshjeve, kjo zgjedhje u shfuqizua nga Andrea kryeipeshkëv i Tivarit, porse u bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1323 nga Gjoni (Johannes) XXII, i cili e bëri sërish të vlefshme zgjedhjen e tij të para një viti.¹²⁷

XI. *B. Ipeshkëv i Drishtit (B. Episcopus Drivastensis), viti 1351*

Emri i këtij ipeshkvi është i shënuar vetëm me inicialin B. U bë ipeshkëv në vitin 1351, por më tepër nuk dihet asgjë rreth tij.¹²⁸

¹²³ “*Henricus Legatus Apostolicus anno 1153. cum Petrum Drivastensem, tum Joannem Olciniensem Episcopos Sede episcopali dejectos anathemati mulctavit, propterea quod vocat ad Synodum provincialem, quod ipse Ragusium convocaverat, adesse noluerunt, ut in Ragusiensi Ecclesia diximus.*” Farlati: *Illyrici Sacri VII*, f. 235.

¹²⁴ *Krh.* Po aty.

¹²⁵ *Krh.* Po aty.

¹²⁶ *Krh.* Po aty, f. 236.

¹²⁷ *Krh.* Po aty.

¹²⁸ *Krh.* Po aty.

XII. Gjoni, Ipeshkëv i Drishtit (Johannes Episcopus Drivastensis), viti 1360

Gjoni që ipeshkëv i Drishtit nga viti 1360 deri në vitin 1373, por që nga ky vit papa Gregori XI e transferoi atë në Arqipeshvinë e Tivarit.¹²⁹ Ky ipeshkëv ishte i lidhur shumë me Balshajt.¹³⁰ Ai i përkiste familjes së njohur Lepore (de Leporibus) nga Drishti dhe ishte i njohur edhe si “*auditor*” dhe “*examinator*” për komunat dalmatine, “*judices et contractus*”, fisnik i vërtet në Lokrum dhe në Mlet, si dhe i njohur si njeri i ditur në Braç dhe Hvar.¹³¹

XIII. Bernardi, Ipeshkëv i Drishtit (Bernardus Episcopus Drivastensis), viti 1373

Bernardus u bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1373, por pas një viti u transferua në kishën e Kotorrit,¹³² sepse me sa duket nuk kishte raporte të mira as me klerin, as me popullin e Drishtit.¹³³ Mesa duket Bernardi ishte nga Kotorri.¹³⁴

XIV. Athanasius, Ipeshkëv i Drishtit (Athanasius Episcopus Drivastensis), viti 1374

Athanasius u emërua Ipeshkëv i Drishtit nga papa Gregor XI në prill të vitit 1374, dhe zëvendësoi Bernardin e lartpërmendur, mbi origjinën e tij nuk dimë asgjë, por mesa duket vinte nga Italia, pasi para se të bëhej ipeshkëv i Drishtit, kishte shërbyer në kishën e Shën Andresë në Padova.¹³⁵

¹²⁹ *Krh.* Po aty, f. 237.

¹³⁰ *Krh.* Šufflay: *Stadt und Burgen Albaniens*, f. 52.

¹³¹ *Krh.* *Statutet dhe urdhëresat*, f. 61.

„1368, 16. Martii. Drivasti. *Instrumentum notarii per literas communis manu episcopi scriptas commendatur. --- praud de procuracione huiusmodi clare patuit publico instrumento scripto manu presbyteri Johannis publici notarii comunis Driuasti in anno domini MCCCLXVIII die XVI mensis marcii recomendato cum litera autentica comunis Driuasti scripta manu domini Johannis episcopi dicte civitatis die VIII mensis madii et auctentica per dominum ciuitatis Ragusii --- E documento infra sub 14. Ianuarii 1371 adducto.*“ *AAlb. II*, nr. 237, f. 54.

¹³² “*Joanni in hanc sedem suffectus ne integrum quidem annum illam tenuit, & anno 1374 ad Catharensam Ecclesiam migravit.*” Farlati: *Illyrici Sacri VII*, f. 237.

¹³³ *Krh.* *AAlb. II*, nr. 318, f. 74.

¹³⁴ „[...] venerabilem fratrem nostrum Barnardum Catharensam [...]“ *AAlb. II*, nr. 318, f. 74.

¹³⁵ *Krh.* *AAlb. II*, nr. 318, f. 74.

XV. *Nicolaus II, Ipeshkëv i Drishtit (Nicolaus II Episcopus Drivastensis), viti 1391*

Nicolaus u emërua Ipeshkëv i Drishtit në vitin 1391 dhe ishte i urdhrit françeskan minorit (*ex Ordine Fratrum Minorum*).¹³⁶ Vdiq në vitin 1396. Ishte me origjinë nga Vegla (sot ishulli Kërk (Krk) në Kroaci).

XVI. *Andreas, Ipeshkëv i Drishtit (Andreas Episcopus Drivastensis), viti 1396*

Andreas ishte nga Montanja dhe u emërua ipeshkëv i Drishtit në vitin 1396, por që filloi në vitin 1398 dhe ndenji dy vjet.¹³⁷

XVII. *Bartholomaeus Ipeshkëv i Drishtit (Bartholomaeus Episcopus Drivastensis), viti 1400*

Bartolomeus ishte qytetar venedikas dhe ishte ipeshkëv i Drishtit gjatë viteve 1400-1404, dhe pas këtij viti u largua nga ky post ose për fajin e tij ose për shkak të tjerëve dhe emigroi në Itali në famullinë e Shën Bartolomeut në Rimini dhe shërbeu aty për shumë vjet si famullitar.¹³⁸

XVIII. *Franciscus, Ipeshkëv i Drishtit (Franciscus Episcopus Drivastensis), viti 1404*

Franciscus ishte nga Shkodra, i urdhrit françeskan dhe u bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1404 nga papa Innocentius VII, porse në vitin 1424 iku nga Drishti dhe kaloi në Kishën e Ulqinit.¹³⁹

XIX. *Nicolaus III., Ipeshkëv i Drishtit (Nicolaus III. Episcopus Drivastensis), viti 1424*

Nicolaus III, para se të bëhej ipeshkëv i Drishtit në vitin 1424, kishte qenë në Kishën e Ulqinit, por se në çfarë posti, këtë nuk mund ta mësojmë nga vepra e Farlatit. Si ipeshkëv i Drishtit ai ndenji vetëm pak kohë dhe iku prej aty po në të njëjtin vit. Më tepër nuk dihet rreth tij.¹⁴⁰

¹³⁶ *Krh.* Farlati: *Illyrici Sacri VII*, f. 237.

¹³⁷ *Krh.* Po aty.

¹³⁸ “[...] *vix quadriennium præfuit, & vel ob ejus culpam, vel aliam aob causam amotus in Italiam migravit, atque Arimini in paroecia S. Bartholomei plures anos animarum curam Parochos gessit.*” Po aty.

¹³⁹ “*Patria Scodrensis, religione vitae instituto Franciscanus, cuin Innocentius VII. anno apud Waddingam 1404 Ecclesiam Drivastensem demandavit ... Transit ad Ecclesiam Olciniensem anno 1424.*” Po aty, f. 238.

¹⁴⁰ “*Cui Vuallibastæ cognomn erat. Hic tradita Francisco Olciniensi Ecclesia, qui præerat, abe o Drivastensem recesit ... & eodem anno ab ea amovetur.*” Po aty.

XX. *Dionisius, Ipeshkëv i Drishtit (Dionisius Episcopus Drivastensis), viti 1425*

Dyonysius ishte nga Bohemia nga një familje e shquar të qytetit të Kninit.¹⁴¹ Ai ishte njeri me dije të larta, kishte edhe titullin Magister për teologji dhe u emërua Ipeshkëv i Drishtit në vitin 1425, porse pas dy vjetësh u hoq nga ky post, sepse as nuk ishte administrator i mirë dhe as i denjë për detyrën e ipeshkvit, dhe në vend të tij u vendos si administrator (jo si ipeshkëv) i Kishës së Drishtit F. Bernardo Vivaris.¹⁴²

XXI. *Michael, Ipeshkëv i Drishtit (Michael Episcopus Drivastensis), viti 1428*

U transferua nga posti i ipeshkëvit të Balleas (!) në postin e ipeshkvit të Drishtit më datë 5 tetor 1428, dhe ky ndodhi për shkak të vdekjes së Dionizit, ipeshkvit paraardhës të Drishtit.¹⁴³

XXII. *Paullus, Ipeshkëv i Drishtit (Paullus Episcopus Drivastensis), viti 1445*

Mbiemri i tij ishte Dushi (Dusius), ish-rektor në famullinë e Shën Agustinit në qytetin Traxisos, dhe para se të transferohej në Drisht qe ipeshkëv i Shasit. U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1445. Sipas Farlatit, ky ishte Pal Engjëlli, që shkroi edhe një histori për Skënderbeun.¹⁴⁴

XXIII. *Nicolaus IV, Ipeshkëv i Drishtit (Nicolaus IV Episcopus Drivastensis), viti 1457*

Nicolaus, para se të bëhej ipeshkëv në Drisht ishte famullitar në kishën e Shën Marisë së këtij qyteti dhe kishte edhe postin e kanonikut të kishës së Drishtit, ipeshkv i Drishtit u bë më 9 tetor të vitit 1457, nga papa Kalikstus (Calixtus) III.¹⁴⁵

¹⁴¹ "Natione Bohemus ex illustri familia de Knin ortes [...]" Po aty.

¹⁴² *Krh.* Po aty, f. 238-239.

¹⁴³ "Quem a Balleascensi ad Drivastensem Ecclesiam Martinus V. post Dionzium Sede episcopali privatam transtulit die eodem; v. id. Octobris an. 1428. Translates est Michael olim Episcopus Baleacensis ad Ecclesiam Drinasten. vacantem per privationem factam per Dominum Nostrum de persona F. Dionysii olim Episcopi Drinasten." Po aty, f. 240.

¹⁴⁴ *Krh.* Po aty.

¹⁴⁵ "De summo cognominatus, Canonicus Ecclesiae Drivastensis, idemque Parochus S. Mariae de civitatis veteri diocesis Drivastensis quam Callixtus III, IX Cal. Octobris anno 1457 Ecclesiae Drivastensis praefecit" Po aty, f. 243.

XXIV. Thomas, Ipeshkëv i Drishtit (Thomas Episcopus Drivastensis), viti nuk dihet

Se kur Thomas u bë ipeshkëv i Drishtit, viti nuk dihet, kurse viti i vdekjes së tij është 1489; me sa duket ky ishte ipeshkvi i cili përjetoi pushtimin me shkatërrimin e Drishtit, kur sulltan Mehmeti II rrethoi Shkodrën.¹⁴⁶

Pas këtij ipeshkvi, ata që pasojnë nuk ndodheshin më në Drisht (dhe as në territoret shqiptare), ngaqë ky qytet ishte i pushtuar nga osmanët, braktisur shkatërruar dhe lënë krejtësisht në mëshirën e fatit. Si rrjedhim, kishat e shumta, katedralja dhe ipeshkvia nuk ekzistonin më dhe dalëngadalë nuk u mbeti as shenja as nishani. Pra, këta ipeshkëv të Drishtit që ndoshta nuk e panë kurrë ipeshkvinë e tyre janë:

XXV. Franciscus II. Ipeshkëv i Drishtit (Franciscus II Episcopus Drivastensis), viti 1489

Ishte nga Milano (Mediolanum) u bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1489 dhe në vitin 1496 qe ndihmës i ipeshkvit të Trientit.¹⁴⁷

XXVI. Antonius, Ipeshkëv i Drishtit (Antonius Episcopus Drivastensis), viti 1509

U propozua për titullin e Ipeshkvit të Drishtit nga Papa Julius II më 11 shtator 1509, në një kishë, e cila tashmë ishte shkatërruar në pjesën më të madhe nga jobesimtarët, (këtu duhet të nënkuptohen pushtuesit osmanë) dhe vdiq tre vjet më vonë, në vitin 1512.¹⁴⁸

XXVII. Benedictus, Ipeshkëv i Drishtit (Benedictus Episcopus Drivastensis), viti 1512

Mbiemri i tij ishte *Cornis* (ose *Kernis*). U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1512. Siç del nga Farlati, ky, ngaqë ishte i lidhur me kishën e Varazhdinit (Hungari), e bën edhe kishën e tij në Drisht sufragane të ipeshkvit të Varazhdinit.¹⁴⁹ Nuk dimë asgjë më tepër rreth tij.

XXVIII. Theophilus, Ipeshkëv i Drishtit (Theophilus Episcopus Drivastensis), viti 1516

Ishte i urdhrit kamaldens. U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1516 dhe pas dy vjetësh dha dorëheqje nga titulli i Ipeshkvit të Drishtit për të

¹⁴⁶ *Krh.* Po aty, f. 242-243.

¹⁴⁷ *Krh.* Po aty, f. 243.

¹⁴⁸ *Krh.* Po aty, f. 246.

¹⁴⁹ "In laodatio Prayi catalogo dicitur etiam Sufraganeus Antistitis Varadensis in Hungaria: Benedictus Kernis Episcopus Drivassensis, lege Drivassensis, Sufraganeus Episcopi Varadensis." Po aty.

qëndruar në krye të Manastririt kalamdens të Balneos (Itali), post ky i preferuar prej tij.¹⁵⁰ Rreth tij nuk dimë asgjë më tepër.

XXIX. *Franciscus III., Ipeshkëv i Drishtit (Franciscus III Episcopus Drivastensis), viti 1518*

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1518 dhe vdiq pas një viti. Nuk dimë asgjë më tepër rreth tij.¹⁵¹

XXX. *Johannes II., Ipeshkëv i Drishtit (Johannes II Episcopus Drivastensis), viti 1520*

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1520 dhe vdiq pas një viti (1521) Nuk dimë asgjë më tepër rreth tij.¹⁵²

XXXI. *Gundisalvus, Ipeshkëv i Drishtit (Gundisalvus Episcopus Drivastensis), viti 1521*

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1521 dhe vdiq pas tre vjetësh. Nuk dimë asgjë më tepër rreth tij.¹⁵³

XXXII. *Petrus III., Ipeshkëv i Drishtit (Petrus III Episcopus Drivastensis), viti 1525*

U bë ipeshkëv i Drishtit në vitin 1525. Nuk dihet se në cilin vit mbajti titullin Ipeshkëv i Drishtit, dhe nuk dimë deri tani asgjë më tepër rreth tij.¹⁵⁴

XXXIII. *Franciscus IV., Ipeshkëv i Drishtit (Franciscus IV Episcopus Drivastensis)*

Nuk dihet se në cilin vit u bë ipeshkëv i Drishtit, dhe gjithashtu nuk dihet se në cilin vit vdiq apo u zëvendësua nga një tjetër. Mbiemri i tij ishte *De Solis*.¹⁵⁵

XXXIV. *Alphonsus, Ipeshkëv i Drishtit (Alphonsus Episcopus Drivastensis), viti 1541*

U bë ipeshkëv në vitin 1541 ishte Kanonik (prift i rangut të lartë në një kishë ipeshkvnore) i Kishës Hispaliense (*Ecclesia Hispaliensis*) dhe pas vdekjes së tij pak vite më vonë (data e vdekjes nuk dihet) mbeti për shumë vite pa ipeshkëv, dhe në vitet 1545 dhe 1548 papa

¹⁵⁰ *Krh.* Po aty.

¹⁵¹ *Krh.* Po aty, f. 246-247.

¹⁵² *Krh.* Po aty, f. 247.

¹⁵³ *Krh.* Po aty.

¹⁵⁴ *Krh.* Po aty.

¹⁵⁵ *Krh.* Po aty.

Pali III vuri në krye të kishës së Drishtit, por jo si ipeshkvinj, Palë dhe Andrea Engjëllin (Paulus Angelus, Andrea Angelus)¹⁵⁶

XXXV. *Hieronymus, Ipeshkëv i Drishtit (Hieronymus Episcopus Drivastensis), viti 1636*

Hieronimus Lucichius, qe klerik i urdhrit françeskan (Ordo Min. S. Francisci) dhe qe propozuar ipeshkëv i Drishtit prej papës Urbani VIII më 3 mars të vitit 1636, por që u emërua si i tillë më 17 tetor 1636, pas 91 vitesh gjatë të cilave Ipeshkvia e Drishtit ishte vakante, pra pa ipeshkëv.¹⁵⁷ Sipas Farlatit, ai ka qenë administrator i kishës boshnjake, dhe përveç mbiemrit Lucich, ai kishte edhe mbiemrat Bogol nga babai dhe Vares nga nëna e tij, të cilën e kishte boshnjake.¹⁵⁸ Ka vdekur në vitin 1648 dhe e kanë varrosur në kishën S. Joannis Babtista në Bosnjë.¹⁵⁹

Pas këtij ipeshkvi nuk ka më të tjerë dhe Drishti duket se nuk figuron më si qendër ipeshkvnore në hartën kishtare katolike. Pra këtu është fundi edhe i ipeshkvisë së Drishtit. Kaq pra mund te shkruhet për momentin rreth qytetit të Drishtit, një qytet, i cili para se të shuhej, kishte një histori mbi 1500 vjeçare.

Përmbledhje

Drishti ndodhet rreth 12-13 km në afërsi të Shkodrës në krahinën e Postribës. Në mesjetë ky lokalitet quhej *Drivasto*. Kështjella e këtij qyteti e ka origjinën ndoshta nga koha romakë ose koha ilire. Qyteti ishte i ndarë në pjesën e sipërme (qyteti i sipërm) dhe të poshtme (qyteti poshtë). Qyteti ka qene gjatë mesjetës së hershme pjesë e perandorisë bizantine, gjatë gjysmës së dytë te shekullit XI nën pushtetit e Bodinit të Dioklesë, dhe që nga viti 1185 në duar të serbëve. Prej vitit 1393-1395 Drishti ishte nën sundimin e osmanëve, por që nga viti 1396 nën sundimin e venedikasve.

¹⁵⁶ *Krh.* Po aty.

¹⁵⁷ “3 Martii 1636 providit Urbanus VIII., *Ecclesiae Drivastensis in Macedonia sive Albania complures annos vacant per obitum illius ultimo Episcopus de Persona F. Hieronymi Lucich. Ord. Min. S. Francisci. ... 17. Octobris fuit consecrates in Episcopum Drivastensem in Albania Reverendissimus D. D. Hieronymus Lucich. Ordinis S. Francisci vigore Bullæ SS. DD. Urbani VIII.*” Po aty, f. 248.

¹⁵⁸ *Krh.* Po aty.

¹⁵⁹ *Krh.* Po aty.

Balsha III u mundua ta pushtonte qytetin dy herë dhe në vitin 1418 u shkaktoi drishtjanëve dëme të mëdha. Despotët serbë e patën Drishtin nën sundimin e tyre deri në vitin 1442, porse në aktet serbe Drishti përmendet deri në vitin 1442 si pjesë të “Zetës së poshtme”, më vonë Drishtin e morën venecianët, të cilët e patën këtë qytet nën juridiksionin e tyre deri në vitin 1478. Drishti u pushtua nga osmanët në vitin 1478, dhe gjatë rrethimit të fundit të Shkodrës osmanët sollën në kampin turk 300 drishtjanë të zënë rob, të cilëve sulltan Mehmeti II ua preu kokat të gjithëve para mureve të Shkodrës, me qëllim që t’ua fuste frikën shkodranëve dhe venecianëve brenda kështjellës, dhe këta të pranonin kapitullimin. Pas pushtimit nga osmanët Drishti ra si qytet, u rrënu plotësisht duk e pësuar fatin e shumë qyteteve të tjera që ndodheshin aty përreth, si Sardës, Sapës, Balezos Shasit, etj, dhe nuk u ripërtëri kurrë më.

Në Drisht popullsia e qytetit përbëhej kryesisht nga etni të ndryshme, aty gjejmë elementin roman, atë shqiptar, por edhe ato sllavë dhe grekë. Disa nga mbiemrat e familjeve të Drishtit janë p.sh. të pastër romanë si: *Palombo* ose *Colomba*, *de Leporibus*, etj; mbiemra shqiptarë si: *Bariloth*, *Precalo*, *Scapuder* (1368 gjurma e parë e emrit të popullit shqiptar); dhe mbiemra serbë si: *Beroj*; *Svinja* ose grekë, si: *Calageorgii* dhe *Spano* (*spanos = pa mjekër*).

Në lidhje me zanatet aty dukej se ishte e zhvilluar kryesisht poçeria, kovaçhanat dhe përpunimi i mëndafshit, dhe sidomos punimi me gurë, si dhe vreshtaria dhe ullishtat. Monedhat e Drishtit ishin prej bakri, shumë primitive; disa me ikonën e Shën Mërisë dhe disa të tjera me pamjen e qytetit me kulla dhe me një portë mbi të cilën është i skalitur një zambak, me mbishkrimin “*civitas Drivasti*”.

Përsa i përket administratës, qyteti ka pasur *vojvodën*, që kishte të bënte kryesisht me “policinë”, por edhe me organizmin komunal të qytetit, dhe pastaj *podestas* (*Podesta*), që në shqip “zot, kapiten, njeri me pushtet të plotë në një zyrë të caktuar.” dhe duket se ky post njihej edhe me emërtimin “*castellanus popularis*”. Drishti ka pasur vëllazëri edhe shkolla po në lidhje me shkollat, nuk dimë asgjë, nuk kemi asnjë informacion se, çfarë mësohej në to, por nga Drishti kanë dalë dijetarë, të cilët janë bërë ipeshkëv në provinca të ndryshme dhe kanë hapur edhe shkolla dhe kanë qenë noter edhe jashtë vendit (p.sh. Dalmaci).

Drishti njihet si ipeshkvi që në fund të shekullit të 9-të, por fatkeqësisht deri më sot nuk kemi arritur të kemi një histori të plotë të

kësaj ipeshkvie dhe informacionet më të shumta rreth saj i kemi deri tani nga jezuiti italian, historiani i njohur i kishës Daniele Farlati. Drishti kishte shumë kisha dhe nga studiuesit konsiderohet se ka qenë një ndër fidanishtet më të mëdha të klerit katolik shqiptarë, krahas Shasit (Saucium). Drishti kishte këto katedrale dhe kisha: Katedralja e Shën Mërisë; ajo e Shën Gjergjit; Kisha e Shën Kryqit; e Shën Stefanit; e Shën Françeskut; e Sancta Maria Veteris; e Shën Shelbuemit; e Shën Prendës; e Shënkollit (S. Nicolaus). Ipeshkvit e Drishtit, janë të shënuar që nga viti 877, por emrat e ipeshkvijve të parë janë anonimë. Ipeshkvi i fundit që ka shërbyer në Drisht ishte Toma (*Thomas Episcopus Drivastensis*) me sa duket ky ishte ipeshkvi i cili përjetoi pushtimin me shkatërrimin e Drishtit. Pas këtij ipeshkvi, ata që pasojnë nuk ndodheshin më në Drisht (dhe as në territoret shqiptare), ngaqë ky qytet i pushtuar nga osmanët, ishte braktisur, shkatërruar dhe lënë krejtësisht në mëshirën e fatit.

S u m m a r y

DRISHTI DURING MIDDLE AGES

Drishti (also called Drivasto during Middle Ages) stands around 12 – 13 Km close to Shkodra, in the region of Postriba. This city's castle is thought to date from the Roman or the Illyrian times. During the early middle ages, the city has been part of the Byzantine Empire, during the second half of the 11th century it has been under the reign of Bodini of Dioclea, from 1185 Drishti fell in the hands of the Serbs and from 1393 to 1395 it was lorded by the Ottomans, but from 1396 the Benedicts took its reigns.

Balsha II tried to occupy the city twice and on 1418 he caused great damage to the Drishtans. Later, and until 1442, Drishti was taken by the Serbian Despots. After the Despots, Drishti was under the jurisdiction of the Venetians until 1478. The same year it was occupied then by the Ottomans and afterwards it fell completely as a city.

Drisht's population is composed by several ethnic minorities. We found there the Roman, the Albanian, even the Slav or Greek element. Some of the last names of the families in Drisht are for example: clearly Roman as: *Palombo* or *Colomba*, *de Leporibus*, etc; Albanian last names as: *Bariloth*, *Precalo*, *Scapuder* (1368 the first trace of the name of the Albanian people "Shqiptar"); Serbian last names as: *Beroj*, *Svinja*; or Greek ones as: *Calageorgi* and *Spano* (spanos = beardless).

From an administrative point of view, the city had *Vojvoda*, which principally concerned 'the police' and the communal organization of the city. There was also *Podestas* (Podesta), which means owner, captain, a man with total power in an office, and it seems that this post was also known as "castellanus popularis".

Drishti is also known as an episcopacy since the end of the 9th century and has been considered by the researchers as one of the greatest cradles of the Albanian Catholic Clergy, next to Shasi (Saucium), but unfortunately up to our times we haven't succeeded to have a complete history of this episcopacy.